

VENDIM
Nr. 245, datë 14.11.2024

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“DRIBEN” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 91, pika 1, dhe 92, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1857/13, datë 13.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Driben’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Driben” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857 prot., datë 3.9.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, në fshatin Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 187, datë 12.9.2024, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Driben” sh.p.k., për arsye se shoqëria nuk kishte kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Pas përmbushjes së detyrimit për kryerjen e pagesës nga ana e shoqërisë brenda afateve të përcaktuara në rregullore, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 203, datë 27.9.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.10.2024 dhe 2.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Gjithashtu, me shkresën nr. 2057, datë 8.10.2024, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Në vijim të korrespondencës së zhvilluar me shoqërinë (ku me shkresën nr. 1857/6 prot., datë 4.10.2024, ERE e ka njoftuar atë për vendimin nr. 203/2024 dhe i ka evidentuar informacionin/dokumentacionin e të munguar të këtij aplikimi) dhe shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1857/7 prot., datë 11.10.2024 ka rezultuar se ka ende informacion/dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 232, datë 30.10.2024, është vendosur zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

- Me shkresën me nr. 1857/9 prot., datë 1.11.2024 dhe e-mailin e datës 1.11.2024, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimmarrjen e Bordit për zgjatjen e afatit dhe për sa mbetet ende pa plotësuar për aplikimin e saj. Me e-mailin e datës 12.11.2024, ERE ka rikujtuar shoqërinë për të depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të aplikimit.

- Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se shoqëria ka dokumentuar kryerjen e aplikimit për pajisje me VNM paraprake të re në datën 1.10.2024. Gjithashtu, rezulton se nevojitet të sqarohet më tej me shoqërinë dokumentacioni takues që duhet të depozitohet për vlerën e mbetur të investimit të projektit.

- Në nenin 91, pika 1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet si vijon: *Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.* Në lidhje me zgjatjen e afateve procedurale të një procedure administrative, në nenin 92, pika 2, e ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikon si vijon: *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

- Për sa më lart, vlerësojmë se në rrethanat e një aplikimi të ri për VNM dhe pritjes së miratimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), si dhe për të sqaruar dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim, vlerësojmë zgjatjen deri më datë 21.12.2024 të afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, duke filluar ky afat nga data e aplikimit të shoqërisë për VNM-në paraprake, më datë 1.10.2024.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri më datë 21.12.2024 afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “Driben” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE VNM-në paraprake të re dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare deri më datë 11.12.2024.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Driben” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti